



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 1423/2024  
Data: 21.02.2024

**PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET**

Nga mbledhja e parë -I- për vitin 2024 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 29.01.2024 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Prezent ishte **Kimete Kuka –Hasallari** (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Amir Bushi** (Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale), Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Njohuri me kompetencat e Komitetit për Komunitete.
3. Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë.
4. Rastet Sociale në komunën e Hanit të Elezit.
5. Takim me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.
6. Eventuale

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## 2 Njohuri me kompetencat e Komitetit për Komunitete.

**Kryesuesi** thekson:- me një emision që është organizuar nga Jeta Gjarr imami Musa Vila potencojë që ka disa probleme prej disa arsimtarëve dhe disa punëtorëve komunal që ndikojnë negativisht në mirësjelljen e xhematit e që faktikisht e ndajnë xhematin një grup falen poshtë një grup falen lartë dhe këtë çështje do ta paraqesë edhe në KKSB edhe pse është brengë e jona por nuk jemi mekanizëm që mundemi me i ndërprerë ata. Grupet të cilat shkojnë për ngushëllime kam dëgjuar që kur janë takuar në fshatin Gorancë janë fërkuar masat mes vete dhe kanë pasur fjalë pak të nxehta por unë mendoj që kjo nuk është e mirë. Llogaritni nëse keni ndonjë rast vdekje dhe dikush me ardhur dhe me shprehur ngushëllime në emër të kryetarit të ri , në emër të kryetarit të moçëm dhe çka do të bëhet kur do të vjen një kryetarë i ri. është mirë me ndikuar edhe drejtorët komunal dhe drejtorët e shkollave për këtë çështje. Komiteti për Komunitete në radhët e veta përfshinë shumicën e thjeshtë dhe është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë të autoriteteve komunale. Në pajtueshmëri me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe në statutin komunës , Komiteti për Komunitete përveç që brenda territorit të komunës të siguroi se komiteti për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale praktikave dhe aktiviteteve për të siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar shprehur , mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik , kulturorë, fetarë dhe gjuhësorë si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave brenda komunës dhe ushtron përgjegjësi tjera nëse nuk janë të rregulluara ndryshme me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela** thekson:- çështja e fesë është e lirë dhe munden me vendosë vetë se në cilën Xhami duan me u falë. Shprehja e ngushëllimeve në raste të vdekjes është çështje e lirë dhe raste që u përmend në Gorancë isha edhe unë dhe nuk mundesh me ndalë dikendë mos me fol dhe janë çështje private jashtë institucionit. Kanë me ardhur gjenerata të reja pas neve mos të mbjellim të këqija por ti udhëzojmë më të rinjtë se drejtorët dhe partitë politike i ndërrojnë kur dush por ne kemi me jetuar në këtë komunitet.

**Kryesuesi** thekson:- unë do të kërkoj që ta mbajmë një punëtori dhe të jetë pjesëmarrja më e madhe. Pavarësisht se si doket dhe prej të voglave bëhet e madhe sepse janë shumë, shkon mësuesi në Xhami me u falë nuk i lidhet imamit dhe potencon që nuk e dua këtë imam, e them këtë se po më doket se po bëhet një lloj fushate.

## 3. Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë.

**Kryesuesi** thekson:- si drejtoreshë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale a jeni e kënaqur për punët e tua në QKMF dhe a ka grupe atje .

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- grupacione ka edhe në QKMF. Përgjegjësit e mia ua kam treguar edhe vitin e kaluar. Përgjegjësi e kam për me i zbatuar të gjitha ata udhëzime që vijnë nga Ministria e Shëndetësisë dhe një herit me ju përshtatur objektivave e kryetarit për nevojat e lokalitetit. Qendra e mjekësisë familjare funksiononë njëzet e katër orë . Në bashkëpunim me organizatat kemi arritur me siguruar stafin.

**Kryesuesi** thekson:- mjekët të cilët kanë qenë më herët nuk janë dhe çka është çështja e mjekëve

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- kjo çështje ka qenë e theksime në Han të Elezit se mjekët vetëm nga dy vite e kanë bërë përvojën dhe tash specializimet e bëjnë të vetën dhe secili po mundohet me gjetur veten për profesionin e mëtutjeshëm.

**Resul Suma** thekson:- janë tre apo katër infermierë që ju mbaron kontrata që e kanë pasur me Karitas, a do të ju vazhdohet kontrata.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:-kemi mungesë të buxhetit dhe në momentin që do të shkëputet kontrata nuk mundem me vazhduar. Do të mundohem me ju përmbajt kontratës dy vjeçare me “Islamik Relief”.

#### **4.Rastet Sociale në komunën e Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Amir Bushi** thekson:- jemi në kuadër të drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale , veprojmë në dy sektorës sektorin e skemave sociale dhe sektorin e shërbimeve sociale.

**Kryesuesi** thekson:- krahasim me vitin 2022 dhe 2023 a ka rënë apo është rritur dhuna familjare. Numri i i personave që marrin ndihmë sociale a ka rënë apo si është gjendja.

**Amir Bushi** thekson:- dhuna familjare mendojë se është e njëjta. Te skema sociale ka rënie të rasteve.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- personat që janë rast social dhe që kanë shkuar në Ferizaj a janë përfitues të skemës sociale.

**Amir Bushi** thekson:-nëse kanë të hyra ju ndërprehet dhe po ashtu ju ndërprehet nëse banojnë me qira, mirëpo ka raste që e bartim lëndën nëse i plotëson kriteret për shkak se lënda është në sistem.


#### **5.Takim me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të preparë sipas agjendës

#### **6. Eventuale**

Nuk pati diskutime.

**Procesmbajtësja**  
**Sara Berisha**



**Kryesuesi i Komitetit**  
**Mefail Suma**

